

HANDIKOS

RREGULLORJA MBI PARANDALIMIN E SHFRYTËZIMIT DHE ABUZIMIT SEKSUAL - PShAS

PËRDORUESIT KRYESORË:

Punonjësit e HandiKOS-it dhe personeli përkatës, organizatat partnere, përfituesit, furnizuesit, vullnetarët.

POLITIKAT E LIDHURA:

HANDIKOS Kodi i Sjelljes dhe i Etikës

HANDIKOS Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve

Data e Hyrjes në fuqi: 01.06.2022

Data e Rishikimit të obliguar: 01.06.2023

PËRMBAJTJA:

- I. Hyrje – Objektiva e rregullores
- II. Përkufizimet
- III. Fusha e zbatimit
- IV. Zotimi për PShAS
 - a. Gjashtë parimet themelore
 - b. Kërkesat minimale
- V. Struktura e PShAS
 - a. Parandalimi
 - b. Raportimi
 - c. Reagimi
- VI. Shtojcë

I. Hyrje

Objektiva e Rregullores: Të promovojë politikën e zero tolerancës mbi shfrytëzimin dhe abuzimin seksual (ShAS) për të gjithë punonjësit e HandiKOS-it dhe personelin përkatës dhe të sigurojë që rolet, përgjegjësitë dhe standardet e pritura të sjelljes në lidhje me ShAS të jenë të njohura brenda HandiKOS-it. Të krijojë dhe të mbajë një mjedis të sigurt, pa praninë e ShAS, duke marrë masat e duhura për këtë qëllim, brenda dhe në komunitetet ku HandiKOS operon, përmes punës së fuqishme të parandalimit dhe reagimit.

HandiKOS është e përkushtuar të mbrojë njerëzit që ndihmon dhe me të cilët punon përkrah. Nga të gjithë punonjësit e HandiKOS-it dhe personeli përkatës kërkohet që të sillen në menyrë shembull me përfituesit e projektit ose anëtarët e komunitetit, duke përdorur kujdes të veçantë me klasat më të cenueshme: femijët dhe të rriturit me aftësi kufizuara, të miturit, gratë, të moshuarit dhe të përjashtuarit nga shoqëria. Punonjësit tanë dhe pjesëmarrësit e programit kanë detyrimin të respektojnë standardet me të larta të sjelljes personale dhe profesionale në çdo kohë dhe nuk duhet të abuzojnë me këtë pozicion për të shfrytëzuar ose abuzuar me një person tjetër.

Duke u bazuar në Kodin tonë të Sjelljes dhe Etikës dhe qasjen mbi barazinë gjinore, HandiKOS është e përkushtuar të parandalojë çdo formë të ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual dhe të reagojë fuqishëm kur këto dëme ndodhin. Kjo do të thotë që ne i marrim seriozisht të gjitha shqetësimet dhe do të përgjigjemi fuqishëm si dhe me kohë ndaj të gjitha pretendimeve për abuzim. Askush nuk do të viktimizohet për paraqitjen e një ankese dhe HandiKOS është përkushtuar të punojë me ankuesit dhe viktimat për t'u siguruar që ata janë në qendër të çdo përgjigjeje, që të mos dëmtohen apo të pafuqizohen më tej nga asnjë proces dhe të marrin mbështetje gjatë gjithë kohës.

Në HandiKOS, ne besojmë se të gjithë njerëzit kanë të drejtë të jetojnë jetën e tyre pa dhunë seksuale dhe pa çdo abuzim pushteti, pavarësisht nga mosha, gjinia, seksualiteti, orientimi seksual, paaftësia, feja, aftësia e kufizuar apo origjina etnike. HandiKOS është plotësisht e përkushtuar për të përmirësuar mbrojtjen nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (PShAS) dhe merr një rol udhëheqës në adresimin e sfidave të jashtëzakonshme.

Deklaratë mbi rregulloren

1.1. ShAS shkel normat dhe standardet ligjore ndërkombëtare të njohura botërisht dhe është sjellje e papranueshme dhe sjellje e ndaluar për të gjithë punëtorët humanitarë, duke përfshirë punonjësit e HandiKOS-it dhe personelin përkatës.

1.2. HandiKOS ka një politikë të zero tolerancës ndaj ShAS. Të gjithë punonjësit e HandiKOS-it si dhe personeli përkatës pritet të respektojnë standardet më të larta të sjelljes personale dhe

profesionale në çdo kohë, dhe të ofrojnë ndihmë dhe shërbime humanitare në një mënyrë që respekton dhe nxit të drejtat e përfituesve dhe anëtarëve të komuniteteve lokale të cënueshme.

2. Përkufizimet

2.1. Abuzimi Seksual: Ndërhyrja fizike aktuale apo e kërcënuar e një natyre seksuale, qoftë me forcë ose në kushte të pabarabarta ose detyruese, duke përfshirë prekjen e papërshtatshme, sulmin seksual dhe përdhunimin. Mund të përfshijë gjithashtu ndërhyrje jofizike të kërcënuara ose të vërteta (ekspozim i padëshiruar dhe/ose i paftuar ndaj pornografisë, teksteve, imazheve, e kështu me radhë, ndarja e imazheve, teksteve e kështu me radhë, kërkesat për fotografi të natyrës seksuale etj.).

2.2. Shfrytëzimi Seksual: Për qëllimet e kësaj rregullore, termi 'shfrytëzim seksual' nënkupton çdo abuzim aktual ose në tentativë nga një pozicion i cënueshëm, i pushteti të ndryshëm ose besimit, për qëllime seksuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, përfitimin monetar, social apo politik nga shfrytëzimi seksual i tjetrit.

2.3. ShAS (Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual): janë forma të dhunës mbi baza gjinore (GBV), që përshkruajnë çdo veprim të dëmshëm të kryer kundër vullnetit të një personi që bazohet në dallimet sociale të atribuara në mes grave dhe burrave. Për më tepër, ShAS mund të përfshijë gjithashtu shkeljet në mbrojtjen e fëmijëve kur "sjellja nga (personeli i organizatës) shkakton dëm të konsiderueshëm tek një fëmijë, duke përfshirë çdo lloj të abuzimit fizik, emocional ose seksual, neglizhencë ose shfrytëzim.

2.4. Ngacmimi Seksual: është afërsija seksuale e padëshiruar dhe jo e mirëpritur, kërkesa për favore seksuale, sjelljet verbale ose fizike ose gjestet e natyrës seksuale, ose çdo sjellje tjetër e natyrës seksuale që mund të perceptohet në mënyrë të arsyeshme se shkakton ofendim ose poshtërim ndaj tjetrit. Kjo përfshin gjithashtu sjelljet e natyrës seksuale që krijojnë një mjedis pune frikësues, armiqësor apo ofendues. Ndërsa zakonisht si një model sjelljeje, ngacmimi seksual përfshin dhe mund të marrë formën e një incidenti të vetëm.

2.5. Favoret Seksuale: Çdo akt seksual ose natyrës seksuale, në këmbim të diçkaje si para, mallra, shërbime, mundësi etj. Gjithashtu përfshin kërkesat për fotografi të papërshtatshme, filmime dhe ekspozim ndaj pornografisë etj.

2.6. I mbijetuari: Një person kundër të cilit/saj janë është kryer ShAS ose është bërë përpjekje ndaj tij/saj për tu kryer ShAS. Për qëllimet e PSO (Procedurat Standarde të Operimit), personat që raportojnë ShAS të kryer kundër tyre trajtohen si të mbijetuar për arsye të sigurisë dhe vlerësimit të nevojave të tyre. Standardet kryesore që HandiKOS zbaton për të gjithë të mbijetuarit janë: Siguria, Respekti, Konfidencialiteti dhe Jo-diskriminimi.

2.7. Kodi i Sjelljes: Një grup i standardeve të sjelljes që stafi i një organizate është i detyruar t'u përmbahet.

2.8. Ankuesi: një person që paraqet një pretendim për ShAS tek pika e kontaktit për PShAS ose tek Kryetari i Bordit të Drejtorëve në përputhje me procedurat e përcaktuara. Ky person mund të jetë një i mbijetuar i ShAS ose një person tjetër që është në dijëni të keqbërjes.

2.9. Politika e Zero-tolerancës: shfrytëzimi dhe abuzimi seksual nga stafi i HandiKOS-it (përfshirë këtu edhe nga partnerët, furnizuesit) është i ndaluar dhe se çdo shkelje do të ndëshkohet.

3. Fusha e zbatimit

3.1. Kjo rregullore përcakton qasjen e HandiKOS-it për parandalimin dhe reagimin ndaj ShAS. Kjo rregullore është e detyrueshme për të gjitha zyrat dhe lokacionet e punës së HandiKOS-it, si në nivel organizativ ashtu edhe në nivel projekti. Nëse kjo rregullore kërkon një standard më të lartë se sa ligjet vendore, atëherë kjo rregullore do të mbizotërojë.

3.2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë punonjësit dhe personelin përkatës, si në detyrë ashtu edhe jashtë detyrës, sipas kategorive të mëposhtme:

- Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i HandiKOS-it;
- Të gjithë punonjësit dhe bashkëpunëtorët në të gjitha strukturat dhe projektet e HandiKOS-it në Kosovë dhe jashtë saj;
- Të gjithë subjektet që nuk i takojnë HandiKOS si dhe punonjësit e tyre dhe individët të cilët kanë lidhur partneritet, janë përfitues apo nën-përfitues të granteve me HandiKOS-in, komitetet, shoqatat, organizatat e çdo lloji – duke përfshirë anëtarët dhe stafin e tyre – të mbështetur financiarisht ose ndryshe;
- Konsulentët dhe personat tjerë të pavarur të cilët veprojnë në emër të HandiKOS-it në bazë të kontratave të shërbimit;
- Të gjithë personat që veprojnë vullnetarisht në emër të HandiKOS-it;
- Furnitorët e çdo lloji malli, shërbimi ose pune, duke përfshirë furnitorët aktualë dhe potencialë;
- Të gjithë personat e tjerë që nuk përfshihen në kategoritë e lartpërmendura të cilët kanë nënshkruar kontratë me HandiKOS-in.

3.3. Parimet e përcaktuara me këtë rregullore zbatohen gjatë gjithë kohës, gjatë dhe jashtë orarit të punës dhe gjatë periudhave të pushimit, pa përjashtim.

3.4. Kjo rregullore përcakton veprimet tona në parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual ndaj:

- Pjesëmarrësve të programit (fëmijët, të rinjët, familjet dhe të rriturit me të cilët ne punojmë),
- Anëtarët e komuniteteve me të cilët ne punojmë, si dhe
- Çdo personi që punon në ose në emër të ndonjë prej subjekteve të listuara në seksionin 3.2.

4. Zotimi për PShAS

4.1. HandiKOS do të bëjë çdo përpjekje për të krijuar dhe mbajtur një mjedis të sigurt, të lirë nga ShAS, dhe do të marrë masat e duhura për këtë qëllim në komunitetet ku operon, përmes një kornize të fuqishme PShAS, duke përfshirë masat parandaluese dhe të reagimit.

4.2. Kjo kornizë mbi PShAS-së, afirmon përkushtimin e HandiKOS-it ndaj 6 parimeve për mbrojtjen nga ShAS të cilat janë shpallur në Tetor 2003 nga zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (ST/SGB/2003/13). Këtë 6 (gjashtë) parime janë:

a. Gjashtë parimet themelore:

a.1. ShAS nga punonjësit e HandiKOS-it dhe personeli përkatës përbëjnë akte të keqsjelljes së rëndë dhe për rrjedhojë janë arsye për ndërprerjen e punësimit.

a.2. Aktiviteti seksual me fëmijë (persona nën moshën 18 vjeç) është i ndaluar pavarësisht nga pëlqimi i dhënë. Besimi i gabuar në lidhje me moshën e një fëmije nuk është mbrojtje.

a.3. Shkëmbimi i parave, i punësimit, mallrave ose shërbimeve seksuale, duke përfshirë favoret seksuale apo format e tjera të sjelljeve poshtëruese, degraduese ose shfrytëzuese janë të ndaluara. Kjo përfshin edhe shkëmbimin e ndihmës ndaj përfituesve.

a.4. Ndalohet çdo marrëdhënie seksuale ndërmjet punonjësve të HandiKOS-it ose personelit përkatës me përfituesit e ndihmës apo me anëtarët e tjerë të komuniteteve lokale të cenueshme që përfshijnë përdorimin e pahijshëm të gradës ose pozitës. Marrëdhënie të tilla minojnë besueshmërinë dhe integritetin e punës së ndihmës humanitare.

a.5. Kur një punonjës i HandiKOS-it ose personeli i lidhur ka shqetësime apo dyshime në lidhje me abuzimin ose shfrytëzimin seksual nga një koleg punëtor, qoftë në të njëjtën organizatë apo jo, ai ose ajo duhet t'i raportojë shqetësimet e tilla përmes mekanizmave të vendosur të raportimit.

a.6. Të gjithë punonjësit e HandiKOS-it dhe personeli përkatës janë të obliguar të krijojnë dhe mirëmbajnë një mjedis që parandalon ShAS dhe promovon zbatimin e kësaj rregullore. Menaxherët në të gjitha nivelet kanë përgjegjësi të veçanta për të mbështetur dhe zhvilluar sisteme që ruajnë këtë mjedis.

b. Kërkesat minimale

b.1. Krijimi i kanaleve të raportimit për pretendimet e ShAS në HandiKOS në përbërje prej Pikës së Kontaktit për PShAS si dhe Kryetarit të Bordit të Drejtorëve për të udhëhequr dhe menaxhuar procesin e raportimit dhe reagimit.

b.2. Fushatë ndërgjegjësuese për punonjësit dhe partnerët e HandiKOS-it në lidhje me rregulloren e PShAS-së, parimet dhe mekanizmat e raportimit nëpërmjet posterave, broshurave dhe kanalet të tjera të informimit.

b.3. Për të gjithë stafin e HandiKOS-it ndjekja e trajnimeve për PShAS është e detyrueshme.

b.4. Për aq sa është e mundur ligjërisht, të gjitha proceset e rekrutimit përfshijnë kontrolle të historisë kriminale ose vetë-zbulim të çdo dënimi që lidhet me abuzimin në çfarëdo forme.

b.5. HandiKOS do të sigurojë që hetimet e pretendimeve të ShAS që përfshijnë personelin e saj do të zhvillohen pa vonesë dhe brenda 5 ditëve të punës duke dorëzuar një raport hetimor për të.

b.6. Vendimi i marrë në bazë të rezultateve të hetimit dhe veprimeve të tjera vijuese duhet të merren brenda 5 ditëve pune pas dorëzimit të raportit të hetimit.

b.7. Hetimet do të kryhen nga një ekip hetimor i pavarur dhe ad-hoc i krijuar nga Pika e Kontaktit për PShAS ose nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve brenda 1 dite pas paraqitjes së pretendimit për ShAS.

5. Struktura e PShAS

5.a. Parandalimi:

5.a.1. Vetingu: HandiKOS kontrollon sistematikisht të gjithë kandidatët potencial për punësim në përputhje me procedurat e përcaktuara të shqyrtimit.

5.a.2. Trajnime: HandiKOS mban trajnime të detyrueshme fillestare dhe rifreskuese për të gjithë punonjësit dhe personelin përkatës mbi rregulloren dhe procedurat e PShAS-së të HandiKOS.

5.a.3. Publikimi i rregullore: HandiKOS është i përkushtuar të shpërndajë rregulloren e PShAS-së me personelin, përfituesit, komunitetet dhe të tjerët, dhe ta integrojë atë në trajnime në përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit. Kjo përfshin **Kërkesën e të gjithë personelit për të nënshkruar marrjen dhe konfirmimin e rregullore përkatëse**, shih Deklaratën (Shtojcë I të kësaj rregulloreje).

5.a.4. Klauzola PShAS: Kontratat dhe marrëveshjet e partneritetit të HandiKOS përfshijnë një klauzolë standarde që kërkon nga kontraktorët, furnitorët, konsulentët dhe nën-partnerët të angazhohen për një politikë të zero-tolerancës ndaj ShAS dhe të marrin masa për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur ShAS.

5.b. Raportimi

5.b.1. HandiKOS ka mekanizma dhe procedura të sigurta, konfidenciale dhe të aksesueshme për personelin, përfituesit dhe komunitetet, përfshirë fëmijët, për të raportuar pretendimet e ShAS.

5.b.2. HandiKOS ka krijuar mekanizma të sigurt për raportimin e pretendimeve të ShAS, duke përfshirë: Kutitë e ankesave të vendosura në objektet e zyrave të HandiKOS-it dhe një numër specifik telefoni dhe adresë emaili të administruara nga Pika e Kontaktit për PShAS dhe/ose Kryetari i Bordit.

5.b.3. Raportet anonime lejohen dhe ato ndiqen duke përdorur të njëjtin proces raportimi dhe reagimi. Ne i inkurajojmë raportuesit të japin identitetin e tyre në mënyrë që rishikimi dhe ndjekja të mund të bëhet më shpejt.

5.b.4. HandiKOS është e përkushtuar që të sigurojë që procedurat e raportimit dhe hetimit të jenë konfidenciale. Organizata kufizon numrin e njerëzve që kanë akses në informacionin e raportuar dhe heq informacionin identifikues të atyre që janë të përfshirë gjatë ndarjes së informacionit.

5.c. Reagimi

5.c.1. HandiKOS është e përkushtuar të mbrojë sigurinë dhe të drejtat e personave të përfshirë, duke përfshirë të mbijetuarit, dëshmitarët dhe autorët e dyshuar. HandiKOS siguron që hetimet të jenë të përqendruara te të mbijetuarit, duke respektuar të drejtat e të mbijetuarve për siguri, konfidencialitet, respekt dhe mosdiskriminim.

5.c.2. Hetimi: HandiKOS ka një proces për hetimin e pretendimeve të ShAS dhe në mënyrë të duhur dhe pa vonesë do të kryejë një hetim të ShAS nga punonjësit e saj ose personeli përkatës ose do t'i referohet ekipit të duhur hetimor nëse kryesi është i lidhur me një subjekt tjetër. (shih Shtojcë II të kësaj rregullore).

5.c.2.1 Procedurat/procesi me shkrim për shqyrtimin e pretendimeve të ShaS: Pas marrjes së ankesës, pika e kontaktit për ShAS së bashku me kryetarin e bordit mbrenda 24 oreve formojnë Ad Hoc Ekipen Hetimore prej 3 anetarëve e cila në mënyrë të pavarur do të bëjnë raportin mbrenda 5 ditëve të punës duke u bazuar në prova, dëshmitarë dhe intervista. Më pas Ad Hoc Ekipa dorëzon raportin te pika e kontaktit për ShaS dhe kryetari i bordit, të cilët marrin vendimin e duhur duke u bazuar në Kodin Sjelljes, Ligjet në fuqi dhe kontratën punës/partneritetit.

5.c.3. HandiKOS është e përkushtuar të identifikojë dhe menaxhojë konfliktin e interesit duke verifikuar që personeli dhe ekspertët e jashtëm të përfshirë në hetim nuk kanë marrëdhënie personale ose profesionale me të mbijetuarin, dëshmitarët, ankuesit/sinjalizuesit ose autorin e supozuar ose atë që kanë interes të veçantë në rezultatin, të hetimit, gjë që mund të cenojë objektivitetin e tyre. Nëse HandiKOS ose dikush tjetër vihet në dijeni për një konflikt të tillë interesit, HandiKOS menjëherë do ta largojë individin në fjalë nga rasti, do t'i ndalojë ata nga kontaktet e mëtejshme me të gjitha palët e përfshira në rast dhe do t'u kërkojë atyre që të pajtohen me shkrim për të mbajtur konfidenciale informacionet në lidhje me rastin.

5.c.4. Nëse HandiKOS nuk ka burimet e nevojshme njerëzore për të kryer një hetim të pavarur mbi ShAS, HandiKOS-i do të punësojë/rekrutojë një hetues të jashtëm me përvojë, të paanshëm dhe të trajnuar për të kryer këtë hetim mbi ShAS; ose angazhimin e partnerit/ëve për mbështetje.

5.c.5. Referim tek Autoritetet Shtetërore: Nëse, pas hetimit të duhur, ka prova për të mbështetur pretendimet për ShAS, këto raste duhet t'u referohen autoriteteve shtetërore për ndjekje penale.

5.c.6. Ndihma për viktimat: HandiKOS ka një sistem për t'i referuar menjëherë të mbijetuarit e ShAS tek shërbimet në dispozicion, bazuar në nevojat dhe pëlqimin e tyre.

5.c.7. Në bazë të rezultateve të hetimit, grupi hetimor do t'i raportojë Pikës së Kontaktit për PShAS dhe Kryetarit të Bordit dhe do të i'u propozojë veprimet që duhen marrë.

5.c.8. Të mbijetuarit dhe autorët e dyshuar kanë të drejtë të komentojnë rezultatet e hetimit para dhe pas marrjes së vendimit. Kjo mund të bëhet përmes një seance dëgjimore zyrtare ose me shkrim.

5.c.9. Të gjitha pretendimet që konstatohen si të vërteta janë subjekt i masave disiplinore bazuar në Kodin e Sjelljes së HandiKOS, në kontratën e punonjësve dhe ligjet nacionale në fuqi.

Shtojcë I. Deklarata

DEKLARATË

për

RREGULLOREN MBI PARANDALIMIN E SHFRYTËZIMIT DHE ABUZIMIT SEKSUAL
PShAS

Emri dhe Mbiemri: _____

Nr. Personal: _____

Pozita: _____

Organizata/Projekti: _____

Unë _____, deklaroj se i/e kam lexuar dhe kuptuar Rregulloren mbi parandalimin shfytëzimit dhe abuzimit seksual, nga HandiKos, nga ketu e tutje PShAS.


Unë i/e kuptoj thëniet e saj dhe jam plotësisht i/e përkushtuar në përkrahjen dhe respektimin e PShAS në vendin e punës dhe jashtë, në mes të orarit të punës dhe pas, brenda ambienteve të punës së HandiKOS-it dhe jashtë.

Jam i/e vetëdijshëm se mosrespektimi i rregullores PShAS do të ketë pasoja sipas procedurave të brendshme të organizatës.

Vendi dhe Data _____

Nënshkrimi _____

Shtojcë II. Grafiku për Menaxhimin e Rasteve



Ne mbeshtetje te nenit 5 paragrafi 1 dhe 3 te statutit te Organizates HANDIKOS , Kryesuesi i Kuvendi te Anetareve, aprovon dokumentin e titulluar: Rregullore mbi parandalimin e shfrytezimit dhe abuzimit seksual – PSHAS

Kryesues i Kuvendit te Anetareve, Flamur Bekteshi

FLAMUR BEKTESHI 

Prishtine

01.06.2022

